



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 59, datë 17.07.2026

PËR MIRATIMIN E SHKËMBIMIT TË PRONËS NË ZBATIM TË VKM-SË NR.597, DATË 14.9.2022 “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN E PLANIFIKUAR PËR RINDËRTIM, SIPAS PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E DËMTUAR PIKËSORE PËR 5 BANESA KOLEKTIVE, NË BASHKINË Durrës” SI DHE VKM-SË NR.767, DATË 19.12.2025 “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM SPITALLË, BASHKIA Durrës NË KUADËR TË PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE “MIQËSIA” DHE “AZEM HAJDARI” LOTI II-RRUGA “MIQËSIA”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019; VKM-së nr.7, datë 6.1.2020 “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit” të ndryshuar, VKM-së nr.8, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje” të ndryshuar, VKM-së nr.597, datë 14.9.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore për 5 banesa kolektive, në Bashkinë Durrës” si dhe VKM-së nr.767, datë 19.12.2025 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në Zonën e Re për Zhvillim Spitallë, Bashkia Durrës në kuadër të projektit “Rikonstruksioni i rrugëve “Miqësia” dhe “Azem

Hajdari” loti II-rruga “Miqësia”, Urdhërit nr.224, datë 08.06.2026, nr. 7808 prot, datë 08.06.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e procedurave në zbatim të VKM-së nr.597, datë 14.9.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore për 5 banesa kolektive, në Bashkinë Durrës” si dhe VKM-së nr.767, datë 19.12.2025 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në Zonën e Re për Zhvillim Spitallë, Bashkia Durrës në kuadër të projektit “Rikonstruksioni i rrugëve “Miqësia” dhe “Azem Hajdari” loti II-rruga “Miqësia”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Grupi i Punës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin e shkëmbimit të pronës sipas VKM-së nr. 597, datë 14.9.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore për 5 banesa kolektive, në Bashkinë Durrës”, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Sipërfaqe (m ²)	Sipërfaqe Truall (m ²)	Çmimi m ² Truall	Çmimi m ² Apartament	Sip. që përfiton për truallin	Sip që përfiton (apartament)	Sip. Shërbimi që përfiton	Totali i sip. së apartamentit që përfiton
1	Kastriot Priu	28 Ndërtesë	0	12,945.00	68,750.00	0	28 m2		28 m ²
2	Bledar Vora	204 Njësi Shërbimi	272	12,945.00	68,750.00	51.21512727	51.21 m2	204 m2	51.21 m ²
3	Haxhi Karaboja	41 Godinë Banimi + 14 Njësi Shërbimi	83.1	12,945.00	68,750.00	15.64697455	15.64 m2	14 m2	56.64 m ²
4	Kimete Rushiti, Jonida Pasho (trashëgimtarët ligjorë të Nazmi Rushiti)	28 Ndërtesë	34.63	12,945.00	68,750.00	6.520514182	28 m2		34.52 m ²
5	Kimete Rushiti dhe Jonida Pasho	28 Ndërtesë	28	12,945.00	68,750.00	5.272145455	28 m2		33.27 m ²

2. Të gjithë përfituesit e përcaktuar në tabelën e mësipërme duhet të depozitojnë para kryerjes së shorteut publik, deklaratën noteriale përmes së cilës bien dakord që për sipërfaqet shtesë të paguajnë diferencën sipas përcaktimeve të bëra në VKM-në nr. 597, datë 14.9.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore për 5 banesa kolektive, në Bashkinë Durrës”, ku çmimi për njësi banimi/apartament i përcaktuar në këtë VKM është 68.750 lekë/m².

3. Përfituesi z. Bledar Vora, i cili përfiton 204 m² njësi shërbimi dhe përfituesi z. Haxhi Karaboja, i cili përfiton 14 m², vendodhja/pozicioni i njësive të shërbimit respektive është sipas planvendosjeve përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Miratimin e shkëmbimit të pronës sipas VKM-së nr. 767, datë 19.12.2025 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Spitallë, Bashkia Durrës, në kuadër të projektit “Rikonstruksioni i rrugëve “Miqësia” dhe “Azem Hajdari”, loti II – rruga “Miqësia”, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Sipërfaqe (m ²)	Sipërfaqe Trualli (m ²)	Çmimi m ² Truall	Çmimi m ² Apartament	Sip. që përfiton për truallin	Sip që përfiton (apartament)	Sip. Shërbimi që përfiton	Totali i sip. së apartamentit që përfiton
1	Brunilda Demiri	295 ndërtesë	395	-	-	Shpronësuar në vlerë lekë	295 m2	-	295 m ²
2	Skënder Isufi	23.84 ndërtesë	32.99	16.619	52.500	----		-	34.28 m ²

5. Të gjithë përfituesit e përcaktuar në tabelën e mësipërme duhet të depozitojnë para kryerjes së shorteut publik, deklaratën noteriale përmes së cilës bien dakord që për sipërfaqet shtesë të paguajnë diferencën sipas përcaktimeve të bëra Vendim nr. 767, datë 19.12.2025 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Spitallë, Bashkia Durrës, në kuadër të projektit “Rikonstruksioni i rrugëve “Miqësia” dhe “Azem Hajdari”, loti II – rruga “Miqësia”, ku çmimi i përcaktuar në këtë VKM për njësi banimi/apartamenti është 52.500 lekë/m².
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, si dhe Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 20.07.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
MIRATOHET

EMIRIANA SAKO

POZICIONI KADASTRAL SHK. 1:2000

PLANVENDOSJE E MIRATUAR ME LEJE NDE RTIMI SHIK. 1:2000

Architectural floor plan of the 2nd floor of the 'Lake Beton' building. The plan shows a large central hall (Korridor) and several smaller rooms, including a staircase (Staircase) and a room labeled 'Bijelina 173.0 m²'. The plan is labeled with dimensions and room numbers. A blue circular stamp from the 'Bashkia e Durres' is visible on the left side. The plan is labeled with dimensions and room numbers.

PLANI I VENDOSJES SË STRUKTURËS SHK. 1.200

[illegible]




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 566/17 prot.

Durrës, më 27.07.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS
KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 59 datë 17.07.2026 “ Për miratimin e shkëmbimit të pronës në zbatim të VKM-së nr.597, datë 14.9.2022 “Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore për pesë banesa kolektive, në Bashkinë Durrës”, si dhe VKM-së nr.767, datë 19.12.2025 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e re për zhvillim Spitallë, Bashkia Durrës në kuadër të projektit “Rikonstruksioni i rrugëve “Miqësia” dhe “Azem Hajdari” Loti II- Rruga “Miqësia”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”i ndryshuar (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

**PREFEKTI
ADRIAN GURRA**

